

Përgjigju duke e rrethuar shkronjën para njëres nga përgjigjet e dhëna. Çdo përgjigje e saktë sjell 2 pikë.

Të shkruarit me laps, rrethimi i dy ose më tepër përgjigjeve ose shlyerja e përgjigjes nuk vlerësohet.

TEST ME MË SHUMË PËRGJIGJE TË DHËNA PREJ TË CILAVE VETËM NJË ËSHTË E SAKTË

(Përgjigju me rrethim të vetëm një përgjigje të dhënë nën A, B, C dhe D)

1. Jona duhet të ndaj dy substanca të lëngëta (nga përzierja). Substancat dallohen sipas temperaturës së vlimit. Çka nga inventari qelqor i duhet për ta përmbledhur aparaturën?

- A. Hinkë.
- B. Cilindër i shkallëzuar(menzurë).
- C. Biretë.
- D. Kondensator i Libigut.

2. Një shishe me kimikat është e shenjëzuar me simbolin për rrezik të dhënë më poshtë. Për çfarë substance bëhet fjalë?



- A. Ndezëse.
- B. Oksiduese.
- C. Helmuese.
- D. Koroduese.

3. Cili nga pohimet e dhëna në lidhje me ligjin e ruajtjes së masës **NUK ËSHTË I SAKTË**?

- A. Masa e përgjithshme e reaktantëve dhe produkteve në raksionin kimik nuk ndryshon.
- B. Gjatë zhvillimit të reaksioneve kimike në sistem të hapur gjatë të cilëve ndahet gaz i cili e lëshon sistemin, vërehet zvogëlim i masës së sistemit.
- C. Gjatë zhvillimit të reaksioneve kimike të thjeshta krijohen lloje të reja të atomeve.
- D. Gjatë zhvillimit të reaksioneve kimike atomet nuk shkatërrohen, por rirenditen.

4. Jona ka dashur të kontrolloj nëse materiali i fortë nga i cili është bërë një shufër është alumin. Për këtë qëllim, ka zhvilluar eksperimentin vijues. E ka vendosur shufrën në trekëmbësh. Në njërin skaj të shufrës ka lidhur një copë dyllë. Skajin e kundërt të shufrës e ka nxeh me zjarr. Çka duhet të bëjë Jona për të vërtetuar a është vallë shufra e bërë prej alumini?

- A. Ta mat masën e shufrës.
- B. Ta mat vëllimin e shufrës.

C. Të kontrolloj nëse shufra përçon nxehtësi.
D. Ta kontrolloj fortësinë prej së cilës është e bërë shufra.

5. Cili prej ndryshimeve të mëposhtme është vetëm fizik?

- A. Kondensimi i avullit.
- B. Djegia e qiriut.
- C. Fotosinteza në pjesët e gjelbërta të bimës.
- D. Shtimi i tabletës shushuritëse në gotë me ujë, gjatë të cilës ndahen fluska të gazit.

6. Cili prej ndryshimeve të dhëna është kimik?

- A. Avullimi i parfumit.
- B. Shpërthim i lëndës plasëse.
- C. Shkrirja e akullores.
- D. Nxehtëria deri në vlim e përzierjes së përbërë nga kripa e kuzhinës dhe ujë.

7. Gjatë nxehtësjes së substancës së pastër X fitohet substancë e ngurtë dhe ndahet gaz. Çka paraqet substanca X?

- A. Element.
- B. Substancë e thjeshtë.
- C. Komponim.
- D. Përzierje.

8. Në epruvetë janë të vendosura dy substanca me ngjyrë të bardhë në gjendje agregate të ngurtë. Shtohet ujë, epruveta tundet dhe fitohet ngjyrosje e verdhë. Përbërja e epruvetës filtrohet dhe fitohet fundërrinë me ngjyrë të verdhë dhe filtrat pa ngjyrë. **Vetëm** në bazë të përshkrimit të dhënë mund të përfundohet se:

- A. Në epruvetë zhvillohet reaksion kimik.
- B. Filtrati është substancë e pastër.
- C. Fundërrina me ngjyrë të verdhë është përzierje.
- D. Përbërja në epruvetë është substancë e pastër me ngjyrë të verdhë.

9. Cilat prej substancave të dhëna janë substanca të pastra, e cilat janë përzierje?

I. diamant II. çelik III. kripë e kuzhinës

IV. fosfor V. qumësht

- A. Substanca të pastra janë: I, II, III dhe IV, ndërsa përzierje është: V.
B. Substanca të pastra janë: I dhe IV, ndërsa përzierje janë: II, III dhe V.
C. Substanca të pastra janë: I, III dhe IV ndërsa përzierje janë: II dhe V.
D. Substanca të pastra janë: III dhe IV, ndërsa përzierje janë: I, II dhe V.

10. Cilat prej substancave të dhëna janë substanca të thjeshta, ndërsa cilat komponime?


I. sheqer II. gurrkali III. grafit
IV. klor V. ozon

- A. Substanca të thjeshta janë: III, IV dhe V, ndërsa komponime janë: I dhe II.
B. Substanca të thjeshta janë: I, III dhe IV, ndërsa komponime janë: II dhe V.
C. Substanca të thjeshta janë: IV dhe V, ndërsa komponime janë: I, II dhe III.
D. Substanca të thjeshta janë: III, ndërsa komponime janë: I, II, IV dhe V.

11. Me cilin udhëzim **NUK ËSHTË** e mundur të ndahet KNO_3 nga tretësira ujore?

- A. Me avullim të ujit.
B. Me kristalizim dhe dekantim.
C. Me filtrim.
D. Me distilim.

12. Në figurën e mëposhtme është paraqitur model i thërmijave në një përzierje në kushte standarde. Përzierja do të kishte mundur të jetë e përbërë nga:



- A. Hekur dhe sulfur
B. Helium dhe hidrogjen
C. Hidrogjen dhe oksigjen
D. Fosfor dhe hidrogjen

13. Hana ka marrë detyrë për t'i rradhitur oksidet vijuese: Al_2O_3 , CO , NO_2 , Cu_2O dhe N_2O_5 në varg sipas rritjes së valencës së elementit në oksid. Ndihmoji Hanës.

- A. Al_2O_3 , N_2O_5 , Cu_2O , CO dhe NO_2
B. Cu_2O , CO , NO_2 , Al_2O_3 dhe N_2O_5
C. Cu_2O , CO , Al_2O_3 , NO_2 dhe N_2O_5
D. Al_2O_3 , CO , NO_2 , Cu_2O dhe N_2O_5

14. Marko me kujdes ka shtuar acid klorhidrik në erlenmaer tek i cili më herët ka vendosur copë prej shiritit të magnezit. Cili barazim tekstual e përshkruan reaksionin kimik i cili zhvillohet në erlenmaer?

- A. Magnez + acid klorhidrik → klorur magnezi + hidrogjen
B. Magnez + acid klorhidrik → klorur magnezi + oksigjen
C. Magnez + acid klorhidrik → klorit magnezi + hidrogjen
D. Magnez + acid klorhidrik → oksid magnezi + klor

15. Karboni, azoti dhe oksigjeni janë jometale të grupeve 14-të, 15-të dhe 16-të në tabelën e sistemit periodik. Që të tre elementet janë të radhitur në periodën e njëjtë, njëri pas tjetrit. Në bazë të këtij informacioni, është përcaktuar masa e molekulave nga çdo çift i substancave. Cili prej pohimeve të mëposhtme që i referohen masës është i saktë?

- A. $\text{CO}_2 > \text{O}_3$
B. $\text{CO} > \text{CO}_2$
C. $\text{NO} > \text{CO}$
D. $\text{N}_2 > \text{O}_2$

16. Cila prej molekulave të oksideve të mëposhtme ka numër më të vogël të atomeve?

- A. Oksid azoti(V).
B. Oksid azoti(II).
C. Oksid azoti(I).
D. Oksid azoti(III).

